

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

8.01.2025  
Ora 13:07

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- **Parti Politike:** PD (z. F. Nuri), PS (znj. E. Xhina), Lëvizja Bashkë
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike, kemi në rend dite për shqyrtim këto çështje:

- Projektvendim “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.
- Projektvendim “Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.
- Projektvendim “Për caktimin e strukturës dhe masës së shpërblimit të administratës zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

- Projektvendim “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, po për zgjedhjet e datës 11 maj 2025”.
- Në vijim janë projektvendimet që lidhen me plotësimin e vakancave në këshillat e Bashkisë Fier, Kukës, Pukë, Kamëz, Tiranë dhe Vorë.
- Janë dy projektvendime që lidhen me “Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Arbis Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër dhe Erin Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendim “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”. Po drejtoresha!

**Znj. J. Josifi:** Ju faleminderit! Në mbështetje të nenit 19, shkronja “n”, si dhe 2, të Ligjit Nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetencat që i ngarkohen me ligje të veçanta si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Gjithashtu në mbështetje të nenit 25 pika 5 të Kodit Zgjedhor si dhe të Vendimit nr. 10, datë 23.10.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, kemi paraqitur përpara jush projektvendim “Për miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”. Duke vijuar pas

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

miratimit të të gjithë setit të akteve nënligjore që lidhen me procesin e regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë, por dhe të takimeve publike të testimit operacional të kësaj platforme me të gjithë grupet e interesit: partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, mediat, organizata dhe përfaqësues të diasporës të datës 27 dhjetor, por dhe në vijim në konsultimet me grupe më të vogla dhe demonstrimet që kanë vijuar. Duke qenë në kushtet e të qenit pak ditë para se procesi i regjistrimit të fillojë në datën 11 janar, kemi hartuar rregulloren teknike, thënë kështu për shqyrtimin e kërkesave nëpërmjet kësaj platforme. Rregullorja gjendet si aneks i këtij projektvendimi. Ajo ka për qëllim të përcaktojë procedurat që do të duhet të ndjekë personeli i autorizuar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim të bëra këto përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit. PER kombinon verifikimin biometrik si dhe verifikimin e dokumenteve të identifikimit të lëshuar nga shteti shqiptar si dhe përputhjen e të dhënave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Rregjistrimi, platforma mund të aksesohet si në web ashtu dhe në aplikacionin mobile të KQZ nga faqja e internetit. Siç kemi komunikuar publikisht gjatë këtyre kohëve, fillimisht zgjedhësi duhet të krijojë llogari në PER e më pas të ndjekë hapat për dërgimin e kërkesës së tij për regjistrim. PER do të lexojë automatikisht të dhënat dhe do të verifikojë pamjen e fytyrës me foton e shtetasit në dokumentin e identifikimit. Në momentin e dërgesës së kësaj kërkesë për regjistrim, zgjedhësi mundet të përdorë dokumentin e tij edhe në rastin që ky i fundit nuk është më i vlefshëm dhe do të duhet të sigurojë një të tillë po përmes platformës deri në fund të periudhës së regjistrimit, rast ky i ilustruar dhe demonstruar edhe në takimet publike. Zgjedhësi do të duhet të sigurojë një dokument për të vërtetuar adresën. Janë përcaktuar në rregullore formatet e dokumentit, në kuptimin e një *file* që janë katër: JPEG, PNG, PDF dhe HEIC, si dhe procedura e shqyrtimit të këtyre kërkesave për regjistrim brenda pesë ditëve nga momenti i dërgimit të kërkesës për miratimin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

ose refuzimin e saj. Janë dhënë të gjitha shpjegimet teknike të procesit, se si zgjedhësi krijon llogarinë edhe pastaj ai dorëzon kërkesën për regjistrim. Është një përmbledhje e informacioneve që janë ilustruar dhe shoqëruar me pamje dhe hapat përkatës që do të ndodhin në sistem. Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim nga ana e personelit të autorizuar nga KQZ që në të gjitha rastet do të duhet të respektojë afatin maksimal të përcaktuar në Vendimin nr. 10/2024 të Komisionit Rregullator, brenda pesë ditësh si dhe të respektojë me rigorozitet parashikimet e po këtij vendimi. Praktikisht personeli i autorizuar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të mundet që në Modulin e Shqyrtimit të Kërkesave:

- a) miratojë kërkesën;
- b) refuzojë kërkesën;
- c) ta shtyjë në kohë marrjen e këtij vendimi për t’ju rikthyer më vonë brenda afatit të përcaktuar.

Edhe procesi i shqyrtimit të kërkesave nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është ilustruar publikisht për të gjitha palët. Janë saktësuar në këtë rregullore se cilat janë rolet e përdoruesve në sistem. Në kuptim të administrimit të brendshëm kemi dy role. Ai i administratorit, që bën konfigurimin e sistemit dhe menaxhimin e përdoruesve, si dhe përdoruesit të cilët shqyrtojnë kërkesat. Kemi përcaktuar këtu mënyrën se si konfigurohet PER dhe se si i qaset panelit publik të të dhënave statistikore. Edhe ky i fundit i ilustruar në demonstrimet publike të bëra për partitë politike nëse do të kenë interes të kenë akses në të, apo dhe për organizatat e shoqërisë civile. Paneli informues është një pamje e veçantë me disa të dhëna statistikore për procesin dhe mënyrën se si po menaxhohen kërkesat për regjistrim. Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

miratimin e Rregullores për shqyrtimin nëpërmjet PER të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Hapim diskutimet për përfaqësuesit e partive politike, por edhe të tjerë pjesëmarrës në seancë. Po, kush e do fjalën! Përfaqësuesja e Partisë Socialiste.

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS-së:** Faleminderit zoti Komisioner! Falenderoj dhe administratën për relatimin e aktit! Nisur nga fakti që e konsiderojmë këtë akt mjaft të rëndësishëm sidomos kur bëhet fjalë për procedurat e shqyrtimit të kërkesave që ne si forcë politike e konsiderojmë mjaft të rëndësishëm. Nisur nga fakti që ne nuk kemi pas kohën e mjaftueshme për të shfaqur, apo për të dhënë komente lidhur me përmbajtjen e këtij akti, do të kërkonim kohë për të bërë komentet tona. Duke u nisur dhe nga afatet e ngushta që jemi, do të na mjaftonin qoftë dhe 24-orë për ne që të bëjmë komentet në lidhje me aktin.

**Z. I. Celibashi:** Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Po, faleminderit! Ne jemi njohur me aktin. Në parim kemi vetëm dy elementë që donim t’i diskutonim këtu përpara jush. Është fakti që nëse operatorët...

**Z. I. Celibashi:** Përpara se të shkojmë te shqyrtimi, ndonjë mendim në lidhje me kërkesën e përfaqësueses së Partisë Socialiste që kërkon më shumë kohë?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Atë e lemë në çmim të KQZ-së, në çmimin tuaj. Thjesht në parim desha të sqaroj dy elementë dhe pastaj do të dilja te konkluzioni.

**Z. I. Celibashi:** Dakord!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Ajo që ne si parti politike kemi shqetësim me aktin, ose sugjerim më tepër për përmirësim, do të ishte që vendimmarrja e operatorit të shoqërohej në një farë mënyre, me një listë ditore të vendimmarrjeve të caktuara për vendimin për pranim, ose për refuzim të aplikimeve qoftë edhe për regjistrim në platformë. Kjo vendimmarrje të shoqërohej me një miratim final nga ana juaj si Komisioner. Kjo në mënyrë që vendimmarrja nga pikëpamja juridike dhe administrative ta ketë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, posaçërisht ju si Kryetar i institucionit. Nuk e di nga ana teknike se si mund të zgjidhet në bazë ditore, nëpërmjet një liste të caktuar, por kur të shkojë emaili, patjetër mund të jetë një vendim me një nënshkrim elektronik, pse jo, për çdo lloj vendimmarrje. Ne do të donim që të ishte një vendimmarrje e miratuar posaçërisht nga ana juaj. Kjo është e para. Në përgjithësi do të donim që platforma të parashikonte që aplikacioni të kishte një mundësi teknike, që një aplikim i caktuar, qoftë i pranuar, qoftë i refuzuar, ne si parti politike të kemi transparencë në lidhje me një vendimmarrje të caktuar që mund të kemi një kontestim të caktuar. Ju si KQZ të keni mundësinë teknike që t'i riktheheni atij rasti konkret, pra të rikuperoni ato të dhënë dhe nëse është bërë gabim në pranimin, ose qoftë dhe në refuzimin e kërkesës, ajo të mund të rikuperohet lehtë. Pra, këto dy elementë do të donim që të shtoheshin. Pastaj një vërejtje e përgjithshme është që kur të rishihet drafti, figurojnë dhe disa gabime drejtshkrimore që besoj se do t'i zgjidhë administrata shumë shpejt në rishikimin e ardhshëm. Shprehim

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

dakordësinë tonë që të merret koha e mjaftueshme për t'u përfshirë të gjitha këto shqetësime dhe shqetësimet që mund të kenë subjektet e tjera, patjetër.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, do ta shtyjme për ditën e nesërme vazhdimin e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, duke ju dhënë mundësi përfaqësuesve të Partisë Socialiste për të parë më mirë përmbajtjen e aktit dhe për t'i mundësuar me kohën, paraqitjen e propozimeve dhe rekomandimeve konkrete për përmirësimin e këtij projektakti. Kushdo tjetër që ka interesin, brenda kësaj kohe është i mirëpritur për të sjellë mendime dhe rekomandime.

Do të njoftoheni për ditën e nesërme, për orën kur do të jetë seanca!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

8.01.2025  
Ora 13:20

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri), Lëvizja Bashkë
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë. Po drejtoresha!

**Znj. J. Josifi:** Ju faleminderit! Në mbështetje të neni 25, pika 11 të Kodi Zgjedhor, të ndryshuar, përcaktohet se auditët teknikienë, të miratuar sipas nenit 61 të këtij kodi, kanë të drejtë të kryejnë verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të këtyre auditëve teknikienë si dhe bashkëpunimi i tyre me KQZ-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile përcaktohet me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcakton pika 11 e nenit 25 të kodit. Ndërkohë neni 26, pikat 2 dhe 3 të Kodi Zgjedhor, përcaktojnë se jo më vonë se 30 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 11 Maj 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me vendim dy auditë teknikienë për verifikimin e veprimeve të realizuara nga KQZ-ja për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Udhëzimi Nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGJC”, përcaktohen të drejtat, detyrat dhe kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe auditëve teknikienë, si vijon, ata duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të kenë arsim universitar dhe eksperiencë në fushën e zgjedhjeve;
- Të ketë njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile;
- Të jenë të padënuar penalisht, së bashku me jetëshkrimet e tyre.

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të Kodit Zgjedhor sa i takon mundësimin të votës nga jashtë, me qëllim caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ gjatë procesit të regjistrimit. Në këtë projektvendim parashikohen detyrat shtesë në këtë rast që burojnë nga ndryshimet e ligjit dhe përgjegjësitë e tyre konkrete, të cilat përcaktohen shprehimisht në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij projektvendimi. Unë po ndalem tek aspektet të cilat do të duhet auditët teknikienë të mbulojnë, pa u ndalur në listimin e detyrave konkrete të cilat janë ndarë ndërkohë me të gjithë palët prej ditësh. Praktikisht auditët teknikienë në këtë drejtim, pra në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

kuadër të auditimit të procesit të regjistrimit duhet të auditojnë zbatueshmërinë, përputhshmërinë e sistemit me kuadrin ligjor, rregullator përkatës për këtë proces. Do të duhet të auditojnë arkitekturën e sistemit dhe bazës së të dhënave. Do të duhet të auditojnë procesin e regjistrimit si dhe identifikimit të zgjedhësve nga jashtë. Krahasimin e imazheve të ruajtura në sistem. Algoritmet e përdorura dhe krahasimin e bërë për të verifikuar identitetin. Do të duhet të auditojnë sigurinë e aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave duke kaluar në vlerësim në nivel enkriptimit të log-eve dhe shqyrtim procedurash autentifikimit. Do të duhet të auditojnë dhe të këqyrin rolin e personave përgjegjës të autorizuar nga KQZ-ja për shqyrtimin e kërkesave për regjistrim, si do të trajnohet stafi. Duhet të kenë mundësinë të testojnë integritetin e sistemit, të mund të identifikojnë problematika të paparashikuara, por dhe të bëjnë teste të penetrimit. Do të duhet të verifikojnë performancën e sistemit (load testing) dhe në kohën e përgjigjes, sidomos parë kjo nga këndvështrimi i zgjedhësit që akseson sistemin për të regjistruar një kërkesë për regjistrim. Do të duhet të këqyrin dhe të auditojnë gjurmimin por edhe ndryshimet e bëra. Pra, regjistrat e auditimit (audit logs) si dhe ndryshimet e kryera në sistem, që këto të fundit të jenë gjithashtu të dokumentuara. Sigurisht që ata do të duhet të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet e tyre nga pikëpamja teknike për përmirësime, si dhe të propozojnë masa korrigjuese duke përgatitur një plan veprimi për të adresuar dobësitë apo të përmirësojë sigurinë dhe saktësinë e sistemit. Duke bërë kështu një raport të gjetjeve të auditit dhe duke ua paraqitur atë të gjitha palëve të interesuara. Ndërkohë, kemi pasur mendime të ardhura pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këtë projektvendim. Nëse ndalemi, me sa shoh ka dhe palë këtu prezent nga ata që kanë paraqitur mendim. Për sa më sipër në këtë relacion, brenda kompetencave të veta, në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

proponohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtim dhe miratim ky projektvendim. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po! përfaqësues të partive politike, në lidhje me projektvendimin?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së:** Jo, nuk kemi ndonjë sugjerim shtesë nga ato që kanë propozuar përfaqësuesit tanë që e kanë parë në aspektin teknik të çështjes.

**Z. I. Celibashi:** Po, nga cilat organizata apo parti të tjera ka pasur kontribute me mendime? Cilat, jo përmbajtja e tyre, po thjesht si listim, kemi pasur një kontribut?

**Znj. J. Josifi:** Siç e përmenda, kemi pasur... nga partitë politike, jo nuk kemi pasur kontribut. Kemi pasur kontribut nga dy organizata, nga Organizata KRIIK dhe Organizata ISP. Nëse mundet të ndalem shkurt...

**Z. I. Celibashi:** Nga ato çfarë kanë rekomanduar, qoftë KRIIK dhe ISP kemi integruar në përmbajtjen e këtij projektakti ndonjë rekomandim?

**Znj. J. Josifi:** Nuk janë të reflektuar në versionin që është paraqitur sot, në këtë draft, por mundet t'i shqyrtojmë patjetër në...

**Z. I. Celibashi:** Meqenëse përfaqësuesit e KRIIK-ut janë këtu dhe nëse ata duan ta marrin vetë fjalën, përndryshe nëse nuk kanë ndonjë gjë, po vlerësojmë në atë çfarë keni sjellë me shkrim, mund ta adresojmë dhe akomodojmë në përmbajtjen. Nuk keni ndonjë gjë? Dakord! Edhe nga Instituti i Studimeve Politike?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**Znj. J. Josifi:** Po! Janë sugjeruar që në fushën e përgjegjësive të auditëve teknikienë, të detyrave, të përfshihet edhe verifikimi i trajtimit të rasteve, pretendimeve, apo denoncimeve që vijnë nga subjekte elektorale, grupet e shoqërisë civile, media e të tjerë. Nuk është e listuar në aneksin nr. 1 të vendimit, për faktin se auditët teknikienë, edhe për shkak të gjithë rregullimit të funksionimit të tyre me Udhëzimin nr. 2, në fakt e marrin indicion nga cilado nga palët. Gjithashtu kjo organizatë, sugjeron që në kuadër të transparencës, të publikohet “on line” në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lista e auditëve teknikienë, adresat e komunikimit me ta, gjë që do të ndodhë, patjetër. Caktimi i tyre bëhet me vendim të Komisionerit dhe Nënkomisioneres dhe të gjitha të dhënat, përfshirë dhe raportet e gjetjeve janë të rregulluara se frekuenca dhe publikimi në Udhëzimin nr. 2. Pra, ato janë më shumë pyetje se sa ndryshime konkrete të kërkuara në projektvendim, ose në listën e detyrave të auditëve.

**Z. I. Celibashi:** Atëherë dakord, do ta miratojmë projektvendimin. Do të shohim atë pjesë të atyre rekomandieve të cilat janë për t’u përfshirë në përmbajtje, si ato të KRIIK, ashtu dhe ato të Institutit të Studimeve Politike. Mirë faleminderit!

**Vendimi nr. 15**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**8.01.2025  
Ora 13:30**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e strukturës dhe masës së shpërblimit për administratën zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri), Lëvizja Bashkë
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që ka të bëjë me strukturën dhe masën e shpërblimit për administratën zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve të datës 11 maj 2025. Po Erion!

**Z. E. Meta:** Neni 19, pika 1, germa “b”, “c” dhe “ç” përcaktojnë kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për emërimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve dhe administratës zgjedhore në përgjithësi. Neni 29, pika 3 parashikon se për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të KQZ-së. Në përgatitjen e këtij projektvendimi janë marrë parasysh shqetësimet e përcjella nga administrata zgjedhore si dhe problematikat e evidentuara në proceset zgjedhore pararendëse, veçanërisht zëvendësimet e shpeshta të anëtarëve të KZAZ-ve, nga partitë politike parlamentare

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

me të drejtë propozimi. Projektvendimi synon të krijojë një mekanizëm të drejtë, transparent dhe proporcional për shpërblimin e anëtarëve të administratës zgjedhore, duke siguruar motivim dhe barazi për të gjithë zyrtarët e përfshirë në procesin zgjedhor. Projektvendimi propozon: përcaktimin e shpërblimit bazë dhe të strukturuar sipas funksioneve dhe përgjegjësi të anëtarëve të KZAZ-ve, të KQV-ve dhe GNV-ve. Parashikon gjithashtu diferencimin proporcional të shpërblimit të KZAZ-ve bazuar në volumin e qendrave të votimit dhe vështirësinë gjeografike të zonave të administrimit zgjedhor. Gjithashtu parashikon ndarjen e shpërblimit të anëtarëve të KZAZ-ve sipas fazave të procesit zgjedhor, duke reflektuar intensitetin e punës në secilën fazë. Projektvendimi propozon, caktimin e mekanizmave për shpërblimin proporcional për rastin e zëvendësimeve dhe penaliteteve, për të siguruar zbatim korrekt të detyrave nga administrata zgjedhore. Për sa më sipër, brenda kompetencave të Komisionerit ju paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të partive politike në lidhje me projektvendimin?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jo, nuk kemi shqetësim, ju faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Mirë! U është dërguar për konsultim partive politike, organizatave?

**Z. E. Meta:** Po, nuk ka pasur komente.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Nuk kemi kontribute! Mirë! Atëherë e miratojmë këtë projektvendim sipas draftit të propozuar.

**Vendimi nr. 2**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

8.01.2025  
Ora 13:32

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, për zgjedhjet e datës 11 maj 2025”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika e katërt që ka të bëjë me miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, po Daniela!

**Znj. D. Alimemeti:** Faleminderit! Referuar nenit 19, pikat 1 dhe 2, të ligjit Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ku parashikohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Gjithashtu referuar përcaktimit të nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ dërgon në Komisionet e Administrimit Zgjedhor

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

(KZAZ), materiale zgjedhore që përdoren nga Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen: vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, dhe vula rezervë për KQV-të. Gjithashtu Kodi Zgjedhor, në nenin 103, pika 2 përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

Vula e KZAZ-së: KZAZ – Nr. \_\_\_\_: që përcakton numrin e KZAZ-së;

Vula e KQV-së: “Komisioni i Qendrës së Votimit” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit gjashtëshifror;

Vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial gjashtëshifror;

Vula rezervë: teksti “R” është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”. Formatit dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së dhe vulat rezervë për KQV, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 06.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare, pranë Ministri së Brendshme, me një kosto 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë. Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit dhe shpenzimet do të përballohen nga buxheti i miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, të KQV-së, vulës së kryetarit të KQV-së, vulës rezervë të KQV për zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 Maj 2025. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me projektaktin?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jo! Nuk kemi komente!

**Z. I. Celibashi:** Edhe ky projektakt është konsultuar me partitë politike dhe me organizatat e shoqërisë civile?

**Znj. D. Alimemeti:** Po, sigurisht!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë miratohet dhe ky projektvendim sipas draftit të propozuar.

**Vendimi nr. 14**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**8.01.2025  
Ora 13:35**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancave në Këshillat e Bashkisë: Fier, Kukës, Pukë, Kamëz, Tiranë dhe Vorë”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**- Stafit KQZ: Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta**  
**Parti Politike: PD (z. F. Nuri)**  
**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë. Licela, relatojë për të gjithë këshillat bashkiakë në një!

**Znj. L. Veliu:** Po! Këshilli i Bashkisë Fier, Këshilli i Bashkisë Kukës, Pukë, Kamëz, Tiranë dhe Vorë kanë njoftuar KQZ-në për krijimin e vakancave në këshill. Referuar nenit 164, pika 2 të Ligjit 10 019/2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, KQZ ka proceduar me kandidatët vijues nga lista shumemërore e subjekteve zgjedhore përkatës. Kandidatët për këshilltarë, në bazë të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore përkatëse kanë plotësuar dhe depozituar formularët e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen, emërimin në funksionin publik, duke përfshirë dhe funksionin e këshilltarit të bashkisë. Nga verifikimi, rezulton se

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

kandidatët përkatës të subjekteve, nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. KQZ në zbatim të ligjit 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b”, pika 3, shkronja “c” e Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nëse kandidatët kanë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, si dhe lidhur me verifikimet e gjendjes gjyqësore. DPGjC nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar pranë KQZ-së verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë, ku konstatohet se asnjë nga kandidatët për anëtarë nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, Kreu V të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë bazuar në sa u relatua...

Përfaqësues të partive politike në lidhje me këto?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jo, jo, nuk kemi komente!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier nga kandidati i listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, zonjën Alesia Koroveshi.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës me kandidatin e listës shumemërore të Partisë Bindja Demokratike, zotin Rustem Ahmetaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin e listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, zonjën Leze Kolaj.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Republikane, zonjën Albana Çika.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kamëz me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Saimir Kurti.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Sead Kazanxhiu.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Elisabeta Haka.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Arbis Arif Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni A.S.E (Partia Demokracia Sociale), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Arbis Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni A.S.E (Partia Demokracia Sociale), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**Znj. L. Veliu:** Zoti Arbis Vjerdha anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, më datë 13.5.2019, ka depozituar formularin e vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, brenda afateve ligjore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila konfirmon dhe informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues Arbis Vjerdha, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se zoti Vjerdha ka deklaruar në pyetjen 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Se është proceduar nga policia italiane, në Latina për kryerjen e veprës penale “Rrahje” në prill të vitit 2014. Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent. Prokuroria e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Arbis Vjerdha, sipas të cilit konstatohet si më vijon:

Aktualisht rezulton të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Shkodër. Nga Gjykata Kolegjiale e Latinës, datë 03.07.2019, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Romë më datë 07.12.2022. Nga sa më sipër rezulton se zoti Arbis Vjerdha, anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, i ka përfunduar mandati i anëtarit të këshillit bashkiak dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i këtij ligji. Për sa më sipër, mund të shprehemi vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe në zbatim të nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**Z. I. Celibashi:** Me siguri duhet t'u ketë bërë përshtypje edhe atyre të cilët e kanë pasur vëmendjen për të ndjekur prezantimin e këtij projektvendimi. Bëhet fjalë për një praktikë e cila ka nisur për zgjedhjet e 30 qershor 2019 dhe tani së fundi kanë ardhur informacionet dhe dokumentacioni. Dakord! Faleminderit!

**Vendimi nr. 18**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

8.01.2025  
Ora 13:41

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. J. Josifi, znj. L. Veliu, z.E. Meta
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Erin Gjoni.

**Znj. L. Veliu:** Zoti Erin Gjoni, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Për këtë kandidat më datë 19.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit brenda afateve ligjore. Nga verifikimi i të dhënave rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga Zyra e Gjendjes Civile. Është informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues zoti Gjoni, rezulton të jetë i rehabilituar, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal. Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të zotit Gjoni, ku rezultoi se ka deklaruar: lidhur me pyetjen 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”. Është dënuar në Alba, Itali me vendimin nr. 345/11, datë 27.09.2011, dhe në Mal të Zi. Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4998, datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent. Prokuroria e Përgjithshme, dërgon pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin Gjoni”. Sipas të cilit konstatohet se: Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se zoti Erin Gjoni, në bazë të vendimit penal të formës së prerë me nr. 833/2015, datë 10 dhjetor 2015, të Gjykatës së Apelit Një Anëtarëshe Patra Greqi, është dënuar me dy (2) vite burgim dhe dënimin monetar 1000 (njëmijë) euro, për “Transport të paligjshëm në bashkëpunim” në përputhje me nenet 1, 12, 14, 16, 17, 18, 26/1/a, 47/1, 51, 52, 57, 60, 79 dhe 83 të Kodit Penal si dhe neneve 88/2-1 a, të Ligjit 3386/2025, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009, duke e pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi për tre (3) vite. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit dhe dokumentacionit, nga rezultati i verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme, konstaton se: referuar gremës “c”, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, kur janë dënuar me jo më pak se 2 vite burgim. Në nenin 4 të ligjit nr. 138/2025 citohet se: Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vite nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë. Referuar shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme bazuar në germën “c”, pika 1, neni 2 i ligjit 138/2015, zoti Erin Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate ndodhet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit. Në nenin 10, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se KQZ “shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës”. Sipas përcaktimit të këtij neni, KQZ është organi kompetent për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të një anëtari në këshillin e bashkisë. Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, vlerësojmë se anëtari në Këshillin e Bashkisë Lezhë, zoti Erin Gjoni, referuar nenit 2 pikës 1, shkronjës “c” dhe nenit 4, pika 3 e ligjit 138/2015, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ndodhet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik të anëtarit në Këshillin e Bashkisë Lezhë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Keni bërë njoftim për zotin Gjoni? Jeni këtu? Po, mund të merrni fjalën!

**Përfaqësuesi ligjor i z. E. Gjoni:** Faleminderit zoti Kryetar! Unë jam përfaqësuesi i zotit Erin Gjoni, avokat Arnold Petushi, anëtar i dhomës së Avokatisë Tiranë. Lidhur

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

me çështjen që është për gjykim, dua t'i bëj me dije Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, se i përfaqësuari prej meje nuk ka pasur dijeni mbi këtë vendim të dhënë nga Gjykata e Shtetit Grek. Nuk ka pasur asnjë arësye për ta fshehur këtë gjë, duke qenë se ka deklaruar dhe vendime të tjera që ka qenë i dënuar. Në të tilla kushte ka angazhuar një avokat në shtetin grek për të marrë informacion në lidhje me vendimin në fjalë. Deri në këto momente nuk ka ardhur asnjë përgjigje. Kjo për shkak edhe të pushimeve të fundvitit Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Në të tilla kushte, kërkojmë të shtyhet seanca e sotme për një datë tjetër, në mënyrë që të na vendoset në dispozicion dokumentacioni i kërkuar dhe t'ua vemë në dispozicion dhe juve. Gjithashtu, edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka dalë me vendim për pezullim të hetimeve, deri sa të marrë një informacion nga gjykata e shtetit grek. Vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë e kemi një kopje të njehësuar me origjinalin. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Vetë zoti Gjoni, ka diçka për të thënë, apo mjaftoheni me ato çfarë tha avokati?

**Z. Erin Gjoni:** Po e deklaroj dhe unë. Unë një herë kam qenë në Greqi dhe nuk kam pasur dijeni. Kam bërë kërkesë nga "TEAMS" që të më vijë, por qëlluan ditë pushimi dhe nuk më ka ardhur asnjë dokument. Unë kam qenë në vitin 2012, vetëm një herë në Greqi dhe kam qenë si turist. Kam kaluar tranzit për në Itali, kaq. Kam vizituar Greqinë dhe Italinë. Më parë kam pas jetuar në Itali dhe aty është vendimi i 2015. Unë kam qenë vetëm një herë në Greqi në vitin 2012. Kam bërë kërkesë siç e tha dhe avokati për vërtetimin, ose mbase është bërë ndonjë ngatërresë mbi të dhënat e mia. Kam bërë kërkesën, por ende nuk ka ardhur.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

**Z. I. Celibashi:** Tani, e kam për avokatin këtë pyetje, por dhe për ju nëse pranoni e dëshironi t'i përgjigjeni. Ju jeni njohur me rezultatin e verifikimit nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme.


**Z. Erin Gjoni:** Më kanë thirrur dhe më kanë thënë që ka ardhur kjo shkresë. I thashë që unë nuk kam dijeni, një herë kam qenë kjo është e 2015, unë një herë kam qenë në 2012. Në rregull thanë do të bëjmë kërkesë se si është marrë ky vendim.

**Z. I. Celibashi:** Po pra, jeni njohur! Edhe me këtë raportin që Organi i Prokurorisë së Përgjithshme i ka sjellë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jeni njohur dhe ju?

**Z. Erin Gjoni:** Jo, mbasi është bërë kërkesa. Pasi ju janë deklaruar ju, të dhënat, jam thirrur më pas, nuk më është bërë e njohur më përpara. Unë jam njoftuar tani, mos gaboj në fund të nëntorit, ose fillim i dhjetorit. Letrat te ju, kanë ardhur më përpara. Unë thjesht jam lajmëruar nga sekretaria e këshillit dhe nga një letër që më ka ardhur nga prokuroria. Kam shkuar në Prokurori, më kanë marrë në pyetje dhe kam deklaruar të njëjtën gjë që po ju deklaroj dhe ju. Unë një herë kam qenë në Greqi që në vitin 2012.

**Z. I. Celibashi:** Nuk ka rëndësi kjo, se kjo seancë dhe ky autoritet nuk merret fare me shqyrtimin e një pretendimi të tillë. Kjo është një çështje që i takon organeve të tjera. Sipas ligjit për dekriminalizimit, besoj avokati juaj e di këtë gjë, në një procedurë të tillë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr informacion, apo raport, të themi, nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe sipas ligjit për dekriminalizimin është organi i Prokurorisë së Përgjithshme i cili bën vlerësimin dhe shqyrtimin e të gjitha atyre fakteve që lidhen me një rast si puna e rastit tuaj. Po përpiqem ta shpjegoj

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 8.01.2025*

se çfarë domethënie ka ky proces që zhvillohet sot këtu. Sipas asaj se çfarë ka bërë organi i Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton dhe është ky organ që ka këtë autoritet dhe askush tjetër, avokati më kupton shumë mirë se çfarë jam duke thënë, i cili konfirmon sipas rastit, apo jo dhe thotë që “po, ky person e ka kryer këtë vepër penale, në këtë vend”. Për KQZ-në kaq mjafton. Nuk jemi ne institucioni që shqyrton pretendimin tuaj. Mund të jetë ashtu siç thoni ju. S’kam asnjë arësye që të dyshoj, ose jo këtë gjë, pasi nuk e kam këtë kompetencë. Por, mbetet fakt që organi i prokurorisë për ju, thotë që keni atë dënim që keni në shtetin grek. Tani qëndron, apo jo kjo çështje? Nuk e zgjidh dot këtu. Do të duhej ta kishe zgjidhur më përpara, ose...

***Përfaqësuesi ligjor i z. E. Gjoni:*** Nuk ka pasur dijeni, ndaj kam sjellë aktin e pezullimit.

***Z. I. Celibashi:*** Meqenëse u paraqitët sot në seancë, ne do t’ju japim dhe një afat tjetër, ndoshta 10, ose 15 ditë. Do t’ju njoftojmë për t’ju dhënë mundësinë për të komunikuar edhe një herë me organin e Prokurorisë së Përgjithshme. Nëse ata sjellin një raport të ndryshëm nga ky që kemi sot, atëherë kemi një qasje tjetër dhe ne si institucion. Dakord?

***Z. Erin Gjoni:*** Prokuroria e Përgjithshme e ka bërë kërkesën.

***Z. I. Celibashi:*** Do të duhet të komunikosh me ta. Për ne qëndron ky dokument që kanë sjellë. Po ju jap juve kohë për të bërë një komunikim me ta. Përndryshe, nëse ne kemi këtë dokumentacion që kemi, vendimmarrja besoj është e ditur. Në rregull?

***Z. Erin Gjoni:*** Dakord, faleminderit!

***Z. I. Celibashi:*** Faleminderit, ditë të mbarë! Çështje të tjera nuk kemi! Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

